



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 10.09.2024

Nr: 175

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. SYRJA HYZEDIN ÇOBO, KANDIDAT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN E BASHKISË BERAT, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA DEMOKRATIKE", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 10.09.2024, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Syrja Hyzedin Çobo, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Berat, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike", në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

**Palë të interesuara:** Z. Syrja Hyzedin Çobo, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Berat, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

**Baza ligjore:** Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

Data:10.09.2024 Nr:175  
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Syrja Hyzedin Çobo, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Berat, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike"

## VËREJ:

### I.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati /Anëtar në Këshillin e Bashkisë”.

Z. Syrja Hyzedin Çobo, është propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” si kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Berat, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Për këtë kandidat më datë 28.3.2023, pranë KQZ është depozituar formulari i vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. unik BR-PDSH-5121. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Syrja Hyzedin Çobo, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit:

- a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Syrja Hyzedin Çobo, rezulton se nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.
- b) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Syrja Hyzedin Çobo, nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

### II

Pasi është konstatuar që kandidati nuk është në kushtet e ndalimit për të kandiduar, janë verifikuar të dhëna të tjera në formularin e vetëdeklarimit të z. Syrja Hyzedin Çobo, ku rezultoi se ka deklaruar:

- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 3 “A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoriteti i huaj, për kryerjen e një vepre penale? “subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, *Është dënuar me 20 ditë burg dhe 800 Euro gjobë, në shtator të vitit 2004, për kalim kufiri të paligjshëm dhe pasaportë të fallsifikuar, në Athinë, Greqi.*
- Pyetjes 7 “A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”.  
*Kalim i paligjshëm kufiri dhe pasaportë e fallsifikuar, në shtator të vitit 2004, në Athinë, Greqi.*

Nga konstatimet e mësipërme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 616/41 prot.extra 23, datë 16.08.2024, Drejtorja e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin

Data: 10.09.2024 Nr: 175  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Syrja Hyzedin Çobo, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Berat, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike”

Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Syrja Hyzedin Çobo”, Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Syrja Hyzedin Çobo, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezulton të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile apo ketë përdorur gjeneralitete të tjera përveç atyre të vetëdeklaruaras;
- Rezulton të jetë dënuar me 3 muaj burgim dhe 1500 euro gjobë të ndryshuar dënimit me burgim prej 3 muaj në gjobë monetare për çdo ditë burgimi 4,40 euro, me vendim të formës së prerë nr. 50219, datë 27-9-2004, nga Gjykata B' me Tre Anëtarë e Kundërvatjeve në Flagrancë e Athinës, për kryerje të veprës penale të posedimit dhe përdorimit të dokumentit të udhëtimit të falsifikuar, parashikuar nga nenet 50 prg. 1 dhe 54 prg. 7 të ligjit 2910/01. Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë veprat e këtij të pandehuri, parashkohen aktualisht në nenin 189, praragrafi 1;
- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Rezulton të jetë gjykuar, për kryerje të veprës të posedimit dhe përdorimit të dokumentit të udhëtimit të falsifikuar, parashikuar nga nenet 50 prg. 1 dhe 54 prg. 7 të ligjit 2910/01, nga Gjykata B' me Tre Anëtarë e Kundërvatjeve në Flagrancë e Athinës, Greqi, e cila e ka deklaruar fajtor dhe dënuar me vendimin nr. 50219, datë 27-9-2004;
- Rezulton të jetë arrestuar në flagrancë me datë 26-9-2004, nga Drejtoria e Policisë të Aeroportit Athinë, për veprat të posedimit dhe përdorimit të dokumentit të udhëtimit të falsifikuar, parashikuar nga nenet 50 prg. 1 dhe 54 prg. 7 të ligjit 2910/01;
- Nuk rezulton t'i jetë caktuar ndaj tij masë shtrënguese e sigurisë personale;
- Nuk rezulton të jetë lëshuar ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale;
- Nuk rezulton të jetë marrë për të masa e dëbimit nga një shtet i huaj;
- Nuk rezulton të ketë të tjera indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion me qëllim verifikimi të mëtejshëm:
  - për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - për qënien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;
  - për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
  - dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - përdorimin e të dhënave personale/gjeneraliteteve.

### III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se subjekti vetëdeklarues z. Syrja Hyzedin Çobo, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Berat, i propozuar nga “Partia Demokratike” nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. Referuar të dhënave të disponuara, kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/moszgjedhshmërisë. “Partia Demokratike” në Këshillin e Bashkisë Berat, ka fituar 3 (tre) mandate dhe z. Syrja Hyzedin Çobo, kandidat i listës shumëmemërore të “Partisë Demokratike”, në Këshillin e Bashkisë Berat, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, nuk e ka marrë mandatin e anëtarit të këshillit.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

## **V E N D O S :**

1. Z. Syrja Hyzedin Çobo, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Berat, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të anëtarit në Këshillin e Bashkisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**